

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 25 NËNTOR 2021

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po paraqes sot një amendament lidhur me këtë projektbuxhet të vitit 2022, i cili lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe konkrete me atë dramë të përditshme, të cilën të gjithë në sallë për arsye të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, për shkak të njohjeve të rretheve shoqërore dhe familjare apo të elektoratit me të cilin komunikojnë, ka të bëjë pikërisht me mbështetjen financiare për barnat, me materialet mjekësore dhe shërbimet e tjera për pacientët me COVID. Kjo mbështetje shkon në masën 2 milionë lekë të rinj, më pak se 18 milionë euro dhe bazohet në analizën e shifrave, dhe kësaj analize nuk i ikim dot. Për të qenë korrekt dhe për t'i ikur çdo lloj keqkuptimi, po qëndroj vetëm te shifrat zyrtare. Me shifrat zyrtare numri i rasteve deri tani është te rreth 200 mijë raste, pak më shumë apo pak më pak, 197 mijë. Të trajtuar me rimbursim, sipas shifrave zyrtare të deklaruara publikisht edhe në komisionet parlamentare përkatëse, janë rreth 8000 persona për një vlerë rreth 320 mijë dollarë. Mesatarja e trajtimit të rasteve ka shkuar rreth 1000 dollarë për person, sipas të dhënave zyrtare të organizmave joqeveritare. Në totalin e vet shohim se ka një humnerë mes asaj që shpenzojnë qytetarët dhe asaj që mbështet shteti. Në 22 muaj pandemi shqiptarët kanë paguar nga xhepi 180 milionë euro.

Ndihma korrekte e qeverisë, e zezë mbi të bardhë, është 20 mijë dollarë. Në rendin e tre muajve, nga gushti deri në nëntor janë rreth 60 mijë raste të reja. Duke iu referuar shifrave është e qartë se ka një valë të re pandemie. Diferenca e vetme është niveli i vdekshmërisë, kurse rastet janë pafund. Secili rast, i çdo lloj forme, i lehtë, i mesëm apo i rëndë, kërkon trajtim kompleks me një sërë barnash bazë, materiale mjekësore dhe trajtime të tjera mbështetëse. Kushdo që ka rrotulluar sytë për qark në planin familjar, por edhe më gjerë, ka parë që kërkohen shumë para për të bërë një trajtim normal. Mungesa e këtij trajtimi, qoftë edhe në rastet e një çlirimi nga virusi në mënyrë spontane, ka provuar qartë se ka lënë pasojë afatgjatë shumë të rënda, të cilat mijëra e mijëra qytetarë po i vuajnë. Këtyre realiteteve nuk u ikim dot. Mbështetja është 18 milionë euro, pra që t'ua përkthejmë qytetarëve, më pak se një kilometër rrugë, nga këto rrugët e florinjta që bëjnë këta, nga 23-24 milionë euro. Pra, më pak se 1 km rrugë për të ndihmuar mijëra e mijëra të sëmurë. Më shumë se 63 mijë raste janë brenda tre muajve të fundit. Edhe në pikun e pandemisë, si numër rastesh, numri i infektimeve ka qenë më i ulët. Çfarë do të bëjmë?! Do të vazhdojmë ta trajtojmë në mënyrë rutinore apo të themi se s'ka gjë, le ta heqin hallin vetë, të rrëmojnë një borxh atje e një këtu dhe nesër të mos merren më me sëmundjen, por të merren me hallin e larjes së borxheve, apo më keq akoma, se ka plot të sëmurë dhe të infektuar që nuk trajtohen dot fare për pamundësi financiare?! Kjo ndihmë së bashku me lehtësirat e tjera është minimumi që mund të bëjnë. Unë them sinqerisht se shpresoj shumë që, së paku, ky amendament, ky ndryshim, na bashkon të tërëve, se asnjëri nuk mund të gjejë një argument të vetëm që mund ta

kundërshtojë, pasi rastet janë përditë, buletinet i keni të përditshme. 600 raste të reja në ditë, që, me rendin e 1000 dollarëve për person, do të thotë qindra, mijëra dollarë në ditë, të cilat nuk i mbështet askush. A mund t'i thuhet jo një ndërhyrjeje të tillë? A bëhet fukara qeveria se do të bëjë më pak se 1 km rrugë më pak? Në mënyrë absolute jo. Prandaj shpresoj shumë që për këtë amendament të dilet jashtë ankthit të votimit partizan, pasi është një hall i përbashkët. COVID-i është një mynxyrë që i goditi të gjithë. Sëmundja nuk ndan se si voton apo ku voton, nuk ndan se kush është kryeministri apo jo, por kërkon të jenë të gjithë të barabartë. Shpresoj shumë që, së paku, në mënyrë historike, për një amendament për një çështje që ka tronditur botën, siç është COVID-i, më së fundi të gjejme një reflektim, të lëmë llafet e bukura e të japim një ndihmë konkrete. Faleminderit!